



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**LISTË VERIFIKIMI PËR Kreun X-XIV, të Ligjit Nr.69/2012 “Për Sistemin
Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”**

Nr.

Datë:

Qarku:

Subjekt i inspektuar për herë të:

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SUBJEKTIT

1.	Emri i Subjektit	
2.	Data e Fillimit të aktivitetit	
3.	Lloji i aktivitetit ekonomik	
4.	Adresa - Qendër (Rrugë, Njësi, Telefon)	
5.	Adresa të tjera - Filiale (Rrugë, Njësi, Telefon)	
6.	Përfaqësuesi i subjektit (emër, atësia, mbiemri)	
7.	NUIS - QKR (Nr Unik i Identifikimit)	
8.	Tipi i Pronësisë	Tipi i Subjektit

LISTË VERIFIKIMI PËR Kreun X-XIV, të Ligjit Nr.69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

Subjekti:

Nr.NIPT:

Adresa:

Administratori:

Drejtori i shkollës:

Tel/Cel:

Fax:

E-mail:

Lloji Aktivitetit:(Kopsht/AB/AML)

Në zbatim të Ligjit Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin Nr. 56/2015, datë 28.5.2015; Nr. 48/2018, datë 23.7.2018; 44/2023, datë 15.6.2023)

Nr	Baza Ligjore	Përshkruesit praktikë	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
1	Germa a, Pika 1, Neni 61, Kreu X, Ligji 69/12	A i është dhënë e drejta nxënësit të përzgjedhë një institucion arsimor publik ose privat?		
2	Germa b, Pika 1, Neni 61, Kreu X, Ligji 69/12	A i është dhënë nxënësit e drejta të ndjekë institucionin arsimor publik që është në zonën e përcaktuar nga njësia bazë përkatëse e vetëqeverisjes vendore?		
3	Germa c, Pika 1, Neni 61, Kreu X, Ligji 69/12	A i siguron institucioni arsimor nxënësit shërbim arsimor cilësor, sipas interesave, nevojave dhe mundësive të tij, si dhe ndihmë të posaçme për të përballuar vështirësitë e tij të veçanta të të nxënësit?		
4	Germa ç, Pika 1, Neni 61, Kreu X, Ligji 69/12	A e ka informuar institucioni arsimor nxënësin për të drejtat e detyrimet e tij, rregulloren e institucionit arsimor, për kurrikulën që institucioni i ofron, për format e vlerësimit, për provimet kombëtare?		
5	Germa ç, Pika 1, Neni 61, Kreu X, Ligji 69/12	A e ka vënë në dijeni institucioni arsimor nxënësin me shkrim për rezultatet e ndërmjetme dhe përfundimtare të arsimimit të tij?		

Nr	Baza Ligjore	Përshkruesit praktikë	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
6	Germa ç, Pika 1, Neni 61, Kreu X, Ligji 69/12	A i ka mundësuar institucioni arsimor nxënësit të shprehë pikëpamjet për çështje të arsimit të tij, të ankohet për qëndrimet ndaj tij dhe të ketë vëmendjen e punonjësve të institucionit arsimor për këto pikëpamje e ankesa?		
7	Germa dh, Pika 1, Neni 61, Kreu X, Ligji 69/12	A i ka mundësuar institucioni arsimor nxënësit të zgjidhet në bordin e shkollës, pas moshës gjashtëmbëdhjetë vjeç?		
8	Germa e, Pika 1, Neni 61, Kreu X, Ligji 69/12	A i ka mundësuar institucioni arsimor nxënësit transferimin nga një shkollë në një shkollë tjetër të të njëjtit nivel arsimor?		
9	Germa a, Pika 2, Neni 61, Kreu X, Ligji 69/12	A i respekton nxënësi të drejtat e nxënësve të tjerë dhe të punonjësve të institucionit, të njohura me ligj?		
10	Germa a, Pika 2, Neni 61, Kreu X, Ligji 69/12	A mëson rregullisht nxënësi?		
11	Germa c, Pika 2, Neni 61, Kreu X, Ligji 69/12	A e vijon rregullisht nxënësi procesin mësimor dhe a merr pjesë në veprimtari të tjera të institucionit?		
12	Germa ç, Pika 2, Neni 61, Kreu X, Ligji 69/12	A i respekton nxënësi rregullat e institucionit për mbrojtjen e shëndetit, të sigurisë e të mjedisit dhe a kërkon respektimin e tyre nga nxënësit e tjerë dhe punonjësit arsimorë?		
13	Germa d, Pika 2, Neni 61, Kreu X, Ligji 69/12	A e respekton nxënësi rregulloren e institucionit?		
14	Germa a, Pika 1, Neni 61/1, Kreu X, Ligji 69/12 (shtuar me 44/23)	A ka përfunduar marrëdhënia e punës e punonjësit arsimor, si dhe çdo punonjës tjetër i sistemit arsimor, që punon me fëmijët që nuk është punësuar dhe, kur ka qenë i punësuar, në rast se është i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale?		

Nr	Baza Ligjore	Përshkruesit praktikë	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
15	Germa b, Pika 1, Neni 61/1, Kreu X, Ligji 69/12 (shtuar me 44/23)	A i është përfunduar marrëdhënia e punës punonjësit arsimor, si dhe çdo punonjësi tjetër të sistemit arsimor, që punon me fëmijët, në rast se është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e punonjësit arsimor ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin arsimor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal?		
16	Germa c, Pika 1, Neni 61/1, Kreu X, Ligji 69/12 (shtuar me 44/23)	A përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, veprat penale në kuptim të shkronjës “b” të këtij neni?		
17	Germa b, Pika 2, Neni 62, Kreu X, Ligji 69/12	A ka informuar institucioni arsimor prindin për kushtet e sigurisë, të shëndetit dhe të mjedisit të institucionit dhe kërkon përmbushjen e tyre, sipas standardeve të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar.		
18	Germa c, Pika 2, Neni 62, Kreu X, Ligji 69/12	A e ka informuar institucioni arsimor prindin për veprimtarinë e fëmijës së tij në institucion dhe i ka kërkuar të japë pëlqim për veprimtaritë plotësuese dhe jashtëshkollore që organizon shkolla?		
19	Germa ç, Pika 2, Neni 62, Kreu X, Ligji 69/12	A ka vënë institucioni arsimor në dijeni prindin për drejtimet kryesore të veprimtarisë së institucionit dhe arritjet e institucionit në krahasim me institucione të ngjashme?		
20	Germa a, Pika 3, Neni 62, Kreu X, Ligji 69/12	A kujdeset prindi që fëmija i tij të ndjekë rregullisht institucionin arsimor dhe të mësojë rregullisht?		
21	Germa b, Pika 3, Neni 62, Kreu X, Ligji 69/12	A e njofton prindi institucionin arsimor për ndryshime të shëndetit dhe të sjelljes së fëmijës së tij?		
22	Germa c, Pika 3, Neni 62, Kreu X, Ligji 69/12	A merr pjesë prindi në takimet për çështje që kanë të bëjnë me fëmijën e tij?		
23	Germa ç, Pika 3, Neni 62, Kreu X, Ligji 69/12	A kontribuon prindi në mbarëvajtjen e institucionit?		

Nr	Baza Ligjore	Përshkruesit praktikë	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
24	Pika 1, Neni 63, Kreu XI, Ligji 69/12 (# me 48/18)	A ka mundësuar institucioni arsimor që fëmijët me aftësi të kufizuara të arrijnë zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe të përmirësojnë cilësinë e jetës së tyre, për t'i përgatitur për gjithëpërfshirje në shoqëri dhe në tregun e punës?		
25	Pika 2, Neni 63, Kreu XI, Ligji 69/12 (# me 48/18)	A ka qenë përgjithësisht e përkohshme përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet e arsimit të specializuar për ta?		
26	Pika 2, Neni 63, Kreu XI, Ligji 69/12 (# me 48/18)	A ka qenë parësore përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë?		
27	Pika 3, Neni 63, Kreu XI, Ligji 69/12 (# me 48/18)	A u është garantuar nxënësve me aftësi të kufizuara në dëgjim, shikim dhe komunikim e drejta e edukimit në gjuhën e shenjave, e drejta e përdorimit të shkrimit Brail, si dhe e mjeteve didaktike në formë elektronike të specializuara, në funksion të edukimit të tyre?		
28	Neni 64, Kreu XI, Ligji 69/12	A u është siguruar nxënësve me aftësi të kufizuara arsimimi në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, sipas kriterëve të miratuara nga ministri i arsimit dhe ministri i shëndetësisë?		
29	Pika 2, Neni 64, Kreu XI, Ligji 69/12	A qëndron nxënësi me aftësi të kufizuara në shkollat të specializuara deri në moshën 19 vjeç?		
30	Pika 3, Neni 64, Kreu XI, Ligji 69/12	A ka krijuar njësi arsimore vendore një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi ka shqyrtuar kërkesën e prindit ose të drejtorit të institucionit arsimor, ka dhënë rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm apo të specializuar?		
31	Pika 4, Neni 64, Kreu XI, Ligji 69/12	A e kanë marrë vendimin prindërit nëse fëmija i tyre me aftësi të kufizuara do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë?		

Nr .	Baza Ligjore	Përshkruesit praktikë	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
32	Pika 4, Neni 64, Kreu XI, Ligji 69/12	A kanë mundur prindërit të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur kanë gjykuar se ai nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira.		
33	Pika 6, Neni 64, Kreu XI, Ligji 69/12	A u ka siguruar njësia arsimore vendore, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit të arsimit dhe të ministrit të shëndetësisë, arsimim në shtëpi nxënësve që nuk kanë mundur të ndjekin një shkollë të zakonshme ose të specializuar të arsimit bazë?		
34	Pika 1, Neni 64/1, Kreu XI, Ligji 69/12 (shtuar me 44/23)	A mbështet qendra burimore arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke përmirësuar në vijimësi rezultatet e të nxënësve dhe i përgatisë ata për gjithëpërfshirjen dhe aftësimin për jetën, duke zhvilluar aftësitë e duhura në të gjitha fushat e përditshmërisë së tyre, sipas legjislacionit në fuqi për aksesueshmërinë dhe mosdiskriminimin?		
35	Pika 2, Neni 64/1, Kreu XI, Ligji 69/12 (shtuar me 44/23)	A janë hapur qendrat burimore si institucione arsimore parauniversitare, me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ofrojnë arsim special dhe shërbime për fëmijë me aftësi të kufizuara, sipas legjislacionit në fuqi për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara?		
36	Pika 3, Neni 64/1, Kreu XI, Ligji 69/12 (shtuar me 44/23)	A kanë qendrat burimore punonjës të specializuar në aftësinë e kufizuar, si mësues të arsimit special, mjekë, punonjës të shërbimit psikosocial, terapistë, që ofrojnë shërbime mbështetëse dhe rehabilituese të specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara edhe në shkollat e zakonshme?		
37	Pika 4, Neni 64/1, Kreu XI, Ligji 69/12 (shtuar me 44/23)	A kanë siguruar qendrat burimore mbështetje për gjithëpërfshirjen në kuadër të burimeve që kanë në dispozicion, në bazë të kërkesave të institucioneve arsimore parauniversitare, që arsimojnë nxënësit me aftësi të kufizuara?		

Nr	Baza Ligjore	Përshkruesit praktikë	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
38	Pika 5, Neni 64/1, Kreu XI, Ligji 69/12 (shtuar me 44/23)	A janë përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave kriteret dhe procedurat për hapjen, mbylljen; riorganizimin e institucioneve të arsimit si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të qendrave burimore?		
39	Neni 65, Kreu XI, Ligji 69/12	A mësojnë nxënësit me aftësi të kufizuara sipas planit mësimor e programeve lëndore të zakonshme, të përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor e programeve lëndore të specializuara për ta?		
40	Pika 2, Neni 65, Kreu XI, Ligji 69/12	A është hartuar programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të zakonshme, nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënësve të institucionit e psikologë?		
41	Pika 2, Neni 65, Kreu XI, Ligji 69/12	A është bërë hartimi i këtij programi në bashkëpunim me prindërit e nxënësve?		
42	Pika 2, Neni 65, Kreu XI, Ligji 69/12	A është vendosur ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës?		
43	Pika 3, Neni 65, Kreu XI, Ligji 69/12	A u është siguruar nxënësve me aftësi të kufizuara mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzim të ministrit?		
44	Pika 3, Neni 65, Kreu XI, Ligji 69/12	A janë certifikuar punonjësit arsimorë të institucioneve, që kanë nxënës me aftësi të kufizuara, në programe trajnimi për trajtimin e nxënësve me aftësi të kufizuara?		
45	Pika 4, Neni 65, Kreu XI, Ligji 69/12	A u ka siguruar njësia përkatëse bazë e qeverisjes vendore, nxënësve me aftësi të kufizuara mjediset e përshtatshme të mësimdhënies e të të nxënësve, sipas standardeve të përcaktuara nga ministria?		
46	Pika 1, Neni 66, Kreu XII, Ligji 69/12	A është bërë në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave personale të nxënësve dhe punonjësve në sistemin arsimor?		

Nr	Baza Ligjore	Përshkruesit praktikë	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
47	Pika 2, Neni 66, Kreu XII, Ligji 69/12	A i kanë dhënë nxënësit të dhënat personale, sipas pikës 1, të këtij neni?		
48	Pika 2, Neni 66, Kreu XII, Ligji 69/12	A i ka njoftuar institucioni arsimor paraprakisht personat për këtë detyrim ligjor?		
49	Pika 3, Neni 66, Kreu XII, Ligji 69/12	A i ka mbledhur e përpunuar institucioni arsimor të dhënat personale të personave, të përcaktuar me udhëzim të ministrit, dhe a i ka vendosur ato në dokumentet zyrtare, si dhe në dosjen vetjake të personit?		
50	Pika 4, Neni 66, Kreu XII, Ligji 69/12	A është dhënë pëlqimi për t'i përdorur të dhënat personale nga vetë personi, kur ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç? Përndryshe a është dhënë pëlqimi për t'i përdorur të dhënat personale nga prindërit e nxënësit?		
51	Pika 4, Neni 66, Kreu XII, Ligji 69/12	A është paraqitur pëlqimi me shkrim?		
52	Pika 1, Neni 67, Kreu XII, Ligji 69/12	A i është dhënë e drejta personit të njihet me të dhënat e tij personale, që disponon institucioni arsimor përkatës?		
53	Pika 2, Neni 67, Kreu XII, Ligji 69/12	A kanë vënë punonjësit e institucionit arsimor në dispozicion të të tjerëve, jashtë institucionit, të dhëna personale të një personi, duke treguar identitetin e tij, me përjashtim të rasteve kur personi ka paraqitur kërkesën ose ka dhënë pëlqimin?		
54	Pika 3, Neni 67, Kreu XII, Ligji 69/12	A u ka dërguar drejtuesi i institucionit arsimor zyrtarisht institucioneve, që përcaktohen me udhëzim të ministrit, të dhëna personale pa identifikuar personat?		
55	Pika 4, Neni 67, Kreu XII, Ligji 69/12	A e zbulojnë identitetin e personit rezultatet e nxënësve në provimet kombëtare dhe të dhënat e tyre për hyrjen në institucionet e shkollave të larta, si dhe rezultatet e mësuesve në provimet e kualifikimit?		
56	Pika 5, Neni 67, Kreu XII, Ligji 69/12	A ka dhënë punonjësi i institucionit arsimor të dhëna për arritjet mësimore dhe sjelljen e një nxënësi të institucionit arsimor në mënyrë publike ose t'ia ketë dhënë ato një personi të veçantë?		

Nr	Baza Ligjore	Përshkruesit praktikë	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
57	Pika 6, Neni 67, Kreu XII, Ligji 69/12	A u janë vënë në dispozicion të dhënat personale të një grupi personash institucioneve të tjera për studime, vetëm pas miratimit me shkrim të drejtorit të institucionit arsimor, pa zbuluar identitetin e tyre?		
58	Neni 68, Kreu XIII, Ligji 69/12	A janë vlerësuar si rast i neglizhencës prindërore dhe a janë trajtuar në përputhje me ligjin nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës mos regjistrimi dhe mungesat e paarsyeshme të fëmijës në mësim për më shumë se 25 për qind të orëve mësimore gjatë një viti shkollor?		
59	Pika 1, Neni 69, Kreu XIII, Ligji 69/12	A përbën kundërvajtje administrative hapja dhe ushtrimi i veprimtarisë së institucionit arsimor privat pa licensën përkatëse, sipas këtij ligji?		
60	Pika 1, Neni 69, Kreu XIII, Ligji 69/12	A dënohet kundërvajtësi me dënim administrativ kryesor gjorbë, në vlerën nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë, dhe me dënim administrativ plotësues “ndërprerjen e menjëhershme të veprimtarisë”?		
61	Pika 2, Neni 69, Kreu XIII, Ligji 69/12 (# me 44/23)	A merret nga institucionit përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor në vend me konstatimin e shkeljes nga inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor sipas legjislacionit për inspektimin, vendimi për dënimin e kundërvajtësit, sipas pikës 1 të këtij neni?		
62	Germa a, Pika 1, Neni 70, Kreu XIII, Ligji 69/12 (# me 44/23)	A përbën kundërvajtje administrative, që konstatohet dhe dënohet nga inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor në arsimin parauniversitar me këto dënime administrative kryesore:paralajmërim; Shkelja e kërkesave ligjore për veprimtarinë e institucioneve arsimore private?		

Nr	Baza Ligjore	Përshkruesit praktikë	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
63	Germa b, Pika 1, Neni 70, Kreu XIII, Ligji 69/12 (# me 44/23)	A konsiderohet kundërvajtje administrative, shkelja e kërkesave ligjore për veprimtarinë e institucioneve arsimore private që konstatohet dhe dënohet nga inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor në arsimin parauniversitar me këto dënime administrative kryesore: gjobë në vlerën nga 10 000 deri në 100 000 lekë?		
64	Germa b, Pika 2, Neni 70, Kreu XIII, Ligji 69/12 (# me 44/23)	A vendos inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor në arsimin parauniversitar që dënimi administrativ kryesor, sipas pikës 1 të këtij neni, të shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar edhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim?		
65	Pika 3, Neni 70, Kreu XIII, Ligji 69/12 (# me 44/23)	A propozon institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin shërbimit arsimor, nëse është parë e nevojshme, dënimin administrativ plotësues të pezullimit apo heqjes së licensës për ushtrimin e veprimtarisë, në rast të konstatimit të shkeljeve të rënda, që përbëjnë mosplotësim të kushteve të licensimit për institucionin arsimor privat, nëse inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor në arsimin parauniversitar ka marrë vendimin për dënimin e kundërvajtësit, me dënimin kryesor të parashikuar nga shkronja “b” e pikës 1 të këtij neni?		
66	Pika 3/1, Neni 70, Kreu XIII, Ligji 69/12 (# me 44/23)	A është ndjekur procedura nga inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, sipas legjislacionit për inspektimin?		
67	Pika 4, Neni 70, Kreu XIII, Ligji 69/12	A e ka fituar licensën për vitin pasardhës shkollor institucioni arsimor privat, licensa e të cilit është pezulluar, pasi ka plotësuar kushtet e licensimit?		

Nr	Baza Ligjore	Përshkruesit praktikë	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
68	Pika 5, Neni 70, Kreu XIII, Ligji 69/12	A i ka vendosur nxënësit në institucione të tjera arsimore, publike ose private institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, përkatës, në rast të pezullimit dhe/ose heqjes së një license		
69	Pika 5, Neni 70, Kreu XIII, Ligji 69/12	A janë përballuar nga garancia bankare e institucionit arsimor privat të mbyllur shpenzimet për përfundimin e atij viti shkollor, për të gjithë nxënësit e regjistruar në atë shkollë private?		
70	Pika 5, Neni 70, Kreu XIII, Ligji 69/12	A janë kryer modalitetet e transferimit të nxënësve bazuar në udhëzimin e ministrit?		
71	Germa a, Pika 1, Neni 71, Kreu XIII, Ligji 69/12 (# me 44/23)	A është konsideruar kundërvajtje administrative nga drejtori i institucionit arsimor publik shkelja e kërkesave ligjore për veprimtarinë e institucioneve arsimore publike, që konstatohet dhe dënohet nga inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor, sipas legjislacionit për inspektimin me dënimin administrative kryesor “paralajmërim”?		
72	Germa b, Pika 1, Neni 71, Kreu XIII, Ligji 69/12 (# me 44/23)	A është konsideruar kundërvajtje administrative nga drejtori i institucionit arsimor publik shkelja e kërkesave ligjore për veprimtarinë e institucioneve arsimore publike, që është konstatuar dhe dënuar nga inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor, sipas legjislacionit për inspektimin me dënimin administrativ kryesor “gjobë, në vlerën e gjysmës së pagës mujore”?		
73	Pika 2, Neni 71, Kreu XIII, Ligji 69/12	A është zbatuar pika 2 e nenit 70 edhe në këtë rast?		
74	Pika 3, Neni 71, Kreu XIII, Ligji 69/12 (# me 44/23)	Përveç zbatimit të dënimit administrativ, sipas pikës 1 të këtij neni, a ka informuar institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor në arsimin parauniversitar për shkeljet e konstatuara edhe institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, përkatës?		

Nr	Baza Ligjore	Përshkruesit praktikë	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
75	Pika 3, Neni 72, Kreu XIV, Ligji 69/12	A e kanë përshtatur institucionet arsimore private dhe institucionet arsimore private plotësuese, të licensuara përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për lejet, licensat dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë”, dhe ato të licensuara me ligjin e sipërpërmendur, dokumentacionin e organizimit dhe të funksionimit institucional, si dhe atë mësimor, në përputhje me këtë ligj, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji?		
76	Pika 5, Neni 72, Kreu XIV, Ligji 69/12	A e ka formimin përkatës universitar, a ka ruajtur vendet e punës dhe a u është nënshtruar trajnimeve për përditësimin e dijeve që lidhen me profesionin, personeli mësimdhënës, që është i punësuar me kontratë të përhershme?		
77	Pika 5, Neni 72, Kreu XIV, Ligji 69/12	A vlen ky përcaktim edhe për mësuesit që kanë përfunduar arsimin e lartë pedagogjik 3-vjeçar, përpara hyrjes në fuqi të sistemit të Bolonjës?		
78	Pika 6, Neni 72, Kreu XIV, Ligji 69/12 (# me48/20)	A ka ruajtur vendet e punës dhe u është nënshtruar trajnimeve për përditësimin e dijeve që lidhen me profesionin personeli mësimdhënës, që është i punësuar me kontratë të përhershme dhe që ka mbaruar një shkollë të mesme pedagogjike ose shkollë tjetër të profilizuar për mësuesi, siç janë shkollat e mesme të muzikës, artistike, të gjuhëve të huaja dhe fizkulturës, dhe që ka fituar tri shkallët e kualifikimit?		
79	Pika 6, Neni 72, Kreu XIV, Ligji 69/12 (# me48/20)	A i është njohur personelit mësimdhënës, që ka përfunduar studimet universitare në ish-institutet e larta pedagogjike, diploma e përfutur si arsim i lartë, tetë semestra, për efekt page.		

INSPEKTORËT